



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 99 Prot.

Tiranë më 26/01/2015

REKOMANDIM

Nr. 08, datë 26/01/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 207, datë 21.11.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Ministria e Arsimit dhe Sportit(në vijim MAS) me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.
- Verifikimi i zbatimit të Urdhrit nr.11 datë 01.10.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, është kontrollues publik. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në fushën e arsimit dhe edukimit, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë nëpunës, studentë, nxënës, mësues etj.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar Komisioneri konstaton se pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore mbledhen dhe përpunohen të dhënat personale të nëpunësve të MAS. Kontrolluesi mbledh kategoritë e të dhënave si: emër, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, formimi diplomat, të dhëna për shëndetin, CV dhe të dhëna të tjera të parashikuara në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 përcaktohen rregulla mbi mënyrën e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të nëpunësve. Gjithashtu parashikohet karakteri konfidencial i të dhënave të nëpunësve, të drejtat e aksesit mbi këto të dhëna si dhe faktin e kthimit të

dosjes personale të nëpunësit me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Kontrolluesi ka marrë masa për të garantuar sigurinë e të dhënave personale.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar Komisioneri konstaton se kontrolluesi MAS në faqen e tij në internet www.arsimi.gov.al nuk ka publikuar “politika të privatësisë”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë dhe në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, në lidhje me Formularin e Njoftimit të plotësuar më parë nga kontrolluesi, Komisioneri konstaton mangësi në disa rubrika:

Në rubrikën 1.1: Kontrolluesi nuk ka përditësuar emrin e subjektit fizik ose juridik dhe adresën e website-it.

Në rubrikën 1.2: Kontrolluesi nuk ka përditësuar personin e kontaktit.

Në rubrikën 3.1: Kontrolluesi nuk ka deklaruar kategorinë “Mësues” dhe “Nëpunës”.

Në rubrikën 4.1: Kontrolluesi nuk ka deklaruar të plotë kategoritë e të dhënave personale që përpunohen për subjektet e të dhënave “Studentë”, “Mësues” dhe “Nëpunës”.

Në rubrikën 5.1: Kontrolluesi nuk ka deklaruar se përpunon të dhënën sensitive “shëndeti” për kategorinë “Nëpunës”.

Në rubrikën 6.1: Nuk është evidentuar qëllimi i përpunimit të të dhënave për kategorinë “Nëpunës” (menaxhim i burimeve njerëzore), si dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave në faqen online mësues.arsimi.gov.al për kategorinë “Mësues”, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale, në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi disponon portalin zyrtar të institucionit i cili administrohet nga specialistët e IT-së. Nëpërmjet portalit www.mesues.arsimi.gov.al, kontrolluesi mbledh të dhëna për mësuesit të cilët aplikojnë për vende pune. Sistemi është krijuar dhe administrohet nga specialistët e sektorit të IT-së dhe për këtë arsye kontrolluesi nuk disponon kontratë mirëmbajtje me palë të treta.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk disponon politikë sigurie informacioni lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave nëpërmjet portalit www.arsimi.gov.al, në zbatim të udhëzimit 21, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, mbështetur në nenin 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Për sa i përket verifikimit të zbatimit të Urdhrit nr. 11, datë 01.10.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, konstatohet se kontrolluesi MAS ka marrë masa për zbatimin e Urdhrit sa i përket tërheqjes së të gjithë “pyetësorëve të gjendjes së shëndetit të nxënësve” dhe “kartelave individuale të nxënësve” nga shkollat dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale si dhe pezullimit të procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive të nxënësve deri në momentin e plotësimit të detyrimeve ligjore në zbatim të shkronjës b) pika 1) e nenit 30 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Kjo provohet edhe nëpërmjet përgjigjes zyrtare të MAS, nr.8732/2 prot, datë 02.12.2014, drejtuar Komisionerit.

Komisioneri vlerëson rëndësinë e këtij procesi dhe angazhohet në monitorimin e vazhdueshëm të tij deri në zbatimin nga ana e kontrolluesit të të gjitha detyrimeve në zbatim të Urdhrit të sipërcituar të Komisionerit, me qëllim garantimin e respektimit të dispozitave të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe neneve 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në faqen zyrtare në internet të kontrolluesit www.arsimi.gov.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. (Në plotësimin e kësaj pike të Rekomandimit të mbahet parasysh Opinioni i Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privatë”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare www.idp.al).
2. Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të merren masa për përditësimin e Formularit të Njoftimit, në bazë të konstatimeve të referuara në pjesën arësytuese të këtij rekomandimi.
3. Në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.idp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
4. Në zbatim të udhëzimit 21, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” të Komisionerit të hartohet politika e sigurisë së informacionit lidhur me përpunimin e të dhënave personale në sistemet elektronike, të administruara nga kontrolluesi MAS.

5. Kryerja e këtyre detyrimeve të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, ndërsa detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij Rekomandimi, të realizohet brenda një afati kohor prej 5(pesë) ditësh nga momenti i marrjes në dijeni të këtij rekomandimi.
6. Të vazhdohet me zbatimin e detyrave të lëna në Urdhrin e Komisionerit nr. 11, datë 01.10.2014 gjatë përpunimit të të dhënave personale të nxënësve në kuadër të projektit të ndërmarrë në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 360, datë 15.09.2014 “Për plotësimin e materialeve didaktike të lëndës së edukimit fiziko-sportiv në sistemin arsimor parauniversitar për vitin 2014-2015”.
7. Në zbatim të nenit 32 pika 1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
8. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Besnik DERVISHI

